

Siguri

Alarmante në Prishtinë | Vetëm 15 vjeç dhe me armë në trup – Policia e kap pas të shtënave, 8 gëzhoja në vendngjarje



Sinjali.com

19 Gusht 2026 18:44



Një rast shqetësues është regjistruar të martën në Prishtinë, ku një i mitur vetëm 15-vjeçar dyshohet se ka shtënë me armë, ndërsa kur Policia ka mbërritur në vendin e ngjarjes, armën e kishte ende me vete.

Sinjali ka mësuar detaje për rastin që ka ndodhur më 18 gusht, rreth orës 12:30, në rrugën “Nexhmi Llumnica” në Prishtinë.

Gjithçka nisi pas raportimit për të shtëna me armë, çka bëri që njësitet policore të mobilizohen dhe të dalin menjëherë në lokacion.

Aty Policia hasi të dyshuarin **L.B.– një 15-vjeçar, tek i cili u gjet arma.**

Sipas informacioneve që ka mësuar Sinjali, i mituri ka pranuar para zyrtarëve policorë se kishte shtënë me armën që posedonte.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë edhe hetuesit dhe njësia e Krimteknikës, të cilët kanë kryer ekzaminimet dhe kanë **sekuestruar një armë Ekol me gaz, tetë gëzhoja dhe dy fishekë.**

Pas ndërhyrjes policore, 15-vjeçari është shoqëruar në Stacionin Policor Veriu, ku është intervistuar në prani të prindit dhe avokatit mbrojtës, në përputhje me procedurat për të mitur.

Për rastin është njoftuar Prokurori kujdestar për të mitur, i cili ka nxjerrë aktvendim për ndalimin e tij për 24 orë.

I mituri është dërguar më pas në Qendrën e Mbajtjes.

Rasti është iniciuar për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim i paautorizuar i armës” dhe “Përdorimi i armës”, ndërsa hetimet pritet të zbardhin motivin dhe rrethanat në të cilat ndodhën të shtënat.

Përtej aspektit penal, rasti ngre edhe një çështje serioze: si përfundoi një armë në duart e një 15-vjeçari dhe si arriti deri te përdorimi i saj?

Hetimet për rastin po vazhdojnë.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera